



**Arsyet Ligjore:**

Me aktvendimin e ankimuar, Trupi Gjykses i DHPGJS-se e ka refuzuar padinë e Paditësit/Ankuesit për vërtetimin e të drejtës pronësore si të papranueshme. Sipas arsyetimit ligjor të aktvendimit, DHPGJS-ja nuk ka juridiksion ndaj kësaj padie, pasi që e drejta e Paditësit/Ankuesit ndaj pronës në fjalë është refuzuar më parë përmes aktvendimit nr. 201244, të datës 8 mars 2007, (të marrë nga Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB)).

Në ankesën e tij, Paditësi/Ankuesi ka kërkuar që të anulohet ky aktvendim dhe t'i përcillet çështja trupit gjykses të DHPGJS-se për rigjykim. Paditësi/Ankuesi pohon se ekzistojnë "shkelje esenciale" të ligjit procedural dhe material.

Ankesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

Aktvendimi i ankimuar nga Paditësi/Ankuesi tregon drejt se në pajtim me nenin 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, ankesa kundër atij aktvendimi mund të parashtrohet me shkrim pranë Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimi të atij aktvendimi.

Neni 20.1 i UA të UNMIK-ut 2008/6 thotë se periudha e parashkruar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/4 llogaritet si vijon: Kur periudha e shprehur me ditë llogaritet nga momenti kur ndodh ngjarja këtu dorëzimi i aktvendimit), dita gjatë së cilës paraqitet ngjarja ose ndodh veprimi nuk numërohet se bie në periudhën në fjalë (krahaso nenin 112 (1) të Kodit të Procedurës Civile, Gazeta Zyrtare 4/77-1478 et al e RSFJ-se e cila e parasheh të njëjtën mënyrë).

Aktvendimi i kontestuar i është dorëzuar Paditësit/Ankuesit më 26 tetor 2009, siç është vërtetuar përmes fletëkthesës. Kjo do të t'hotë se periudha prej 30 (tridhjetë) ditësh ka përfunduar më 25 nëntor 2009. Paditësi/Ankuesi e ka ushtruar ankesën e tij më 26 nëntor 2009 (data e pullës postare), që do të thotë 31 (tridhjetë e një) ditë nga pranimi i aktvendimit të Trupit Gjykses, pra një ditë pas afatit.

Prandaj, ankesa e ushtruar pas afatit duhet të refuzohet si e papranueshme.

### III

Paditësi/Ankuesi nuk ka dhënë arsye të justifikuara se pse nuk e ka dorëzuar ankesën për dorëzimin e ankesës para skadimit të afatit kohor për dorëzim të ankesës (neni 21.2 lidhur me nenin 21.3 të UA të UNMIK-ut 2008/6).

Nuk është marrë vendim mbi shpenzimet.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it nënshkruar

Torsten Frank Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it nënshkruar

Ejia-Lisa Helin, Gjyqtare e EULEX-it nënshkruar

Tobias Lapke, Regjistruer i EULEX-it nënshkruar